



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:013985

Datë: 17.04.2024

Numri i dokumentit: 05584038

KF.nr.127/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit "Auto Ostral" SH.P.K. me numër unik identifikues 811337056 dhe seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Kastrati, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, jashtë seancës, mori këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura në kontestin tregtar-administrativ sipas padisë së paditësit "Auto Ostral" SH.P.K. me seli në Ferizaj, e ushtruar kundër të paditurës Dogana e Kosovës, për anulimin e vendimit, për shkak se paditësi ka hequr dorë nga padia.

A r s y e t i m

Paditësi, ka ushtruar padi në këtë gjykatë, më datë 17.03.2023, kundër të paditurës Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, për anulimin e vendimit me nr.01.3.2/2786 të datës 01.03.2023.

Mirëpo, paditësi më datë 11.04.2024, me anë të parashtresës e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë në këtë çështje juridike të konfliktit administrativ.

Në bazë të nenit 31 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) parashihet se "Paditësi mund të heqë dorë nga padia derisa të mos merret vendimi. Në këtë rast gjykata e pezullon procedurën me vendim"

Andaj, gjykata konform nenit 31 par. 1 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.127/23, datë 17.04.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.